



**COVID-19
VACCINE**
Public Health
Advice

Vaksina COVID-19

Informacion i rëndësishëm rreth
vaksinës Pfizer/BioNTech, Comirnaty
Çfarë mund të prisni pas vaksinës
suaj COVID-19 Pfizer/BioNTech,
Comirnaty

Versioni 14
9 gusht 2021



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland

Rreth kësaj fletëpalosjeje

Kjo fletëpalosje ju tregon rreth vaksinës COVID-19 (koronavirusit).

Ajo ju tregon:

- çfarë është COVID-19
- çfarë është vakcina COVID-19
- kush duhet ta bëjë vaksinën
- përse është e rëndësishme që të bëhet vakcina
- kush duhet ta bëjë dhe kush duhet ta shtyjë bërjen e saj
- siguria dhe efektet anësore të vaksinës
- ku mund të merrni më shumë informacion

Ju lutemi lexojeni këtë fletëpalosje me kujdes. Mund të flisni edhe me një profesionist të kujdesit shëndetësor, si për shembull me mjekun tuaj të përgjithshëm (mjekun) ose farmacistin, rreth vaksinës.

Çfarë është COVID-19?

COVID-19 është një sëmundje që mund të prekë mushkëritë dhe rrugët e frymëmarrjes dhe nganjëherë disa pjesë të tjera të trupit tuaj. Ajo shkaktohet nga një virus që quhet coronavirus.

COVID-19 është shumë infektues. Ai përhapet nëpërmjet ajrit përmes stërkalave që krijohen kur njerëzit kolliten ose teshtijnë ose kur ata prekin sipërfaqe ku kanë rënë stërkalat dhe ata prekin sytë, hundën ose gojën e tyre. COVID-19 mund të shkaktojë sëmundje të rënda, shtrim në spital edhe vdekje.

Simptomat më të zakonshme të COVID-19 përfshijnë:

- një temperaturë (temperaturë e lartë prej 38 gradë celsius ose më e lartë)
- një kollë e re - kjo mund të jetë e çdo lloji, jo vetëm e thatë
- mungesë frymëmarrjeje ose vështirësi në frymëmarrje
- humbje ose ndryshim i ndjesisë së të nuhaturit ose shijes - kjo do të thotë se keni vënë re se nuk mund të nuhasni apo shijoni asgjë ose gjërat kanë aromë ose shije të ndryshme

Ju mund të mos i keni të gjitha këto simptoma ose mund të ndiheni në përgjithësi jo aq mirë sa zakonisht. Mund të nevojitet deri në 14 ditë që të shfaqen simptomat. Ato mund të jenë të ngjashme me simptomat tuaja të ftohurit apo gripit.

Nëse keni ndonjë simptomë të COVID-19, vetë-izolohuni (qëndroni në dhomën tuaj) dhe bëni një test të COVID-19.

Për më shumë informacion mbi COVID-19, ju lutemi vizitoni www.hse.ie/coronavirus ose telefononi HSELive në numrin **1800 700 700**.

Kush është më në rrezik nga COVID-19?

Personat më të mëdhenj si dhe njerëzit me disa probleme të caktuara shëndetësore kanë një rrezikshmëri më të lartë që të sëmuren rëndë nëse infektohen me COVID-19.

Çfarë është vakcina COVID-19?

Një vaksinë është një substancë që duhet të përmirësojë imunitetin (mbrojtjen) ndaj një sëmundjeje të veçantë. Vakcina e COVID-19 do t'ju ofrojë mbrojtje ndaj COVID-19. Nëse njerëzit vaksinohen, duhet të reduktohet edhe numri i atyre që sëmurën rëndë ose që vdesin nga COVID-19 në komunitetin tonë.

Vaksinat mësojnë sistemin tuaj imunitar si të mbrohet nga sëmundjet. Është shumë më e sigurt për sistemin tuaj imunitar të mësojë se si t'ju mbrojë nëpërmjet vaksinimit sesa nëpërmjet infektimit me COVID-19.

Kush duhet ta bëjë vaksinën?

Mund ta shikoni listën e grupeve për vaksinim në faqen e internetit:

www.gov.ie/covid19vaccine

Ndërkohë që vendimi për ta bërë vaksinën varet nga ju, HSE-ja, OSH-ja dhe Departamenti i Shëndetësisë ju rekomandojnë fuqishëm që ju ta bëni sa më parë që t'ju ofrohet.

Vaksinat do të bëhen kur të vijnë furnizimet në Irlandë.

Kur t'ju vijë radha, nëpërmjet reklamave ose ftesës së drejtpërdrejtë, ne do t'ju informojmë se si ta bëni vaksinën. Është e rëndësishme të mos e kontaktoni HSE-në për një vaksinë përpara kësaj kohe.

Ju duhet ta lexoni këtë fletëpalosje dhe Fletëpalosjen e Informacionit për Pacientët përpara se ta bëni vaksinën. Ju mund ta gjeni Fletëpalosjen e Informacionit për Pacientët në **www.hse.ie/covid19vaccinePIL**

Ju mund të flisni më parë edhe me një profesionist të kujdesit shëndetësor. Nëse vendosi ta bëni vaksinën, do të jepni pëlqimin tuaj i cili do të regjistrohet. HSE-ja e ofron vaksinën falas.

Përse është e rëndësishme ta bëni vaksinën e COVID-19?

Bërja e vaksinës COVID-19 duhet t'ju mbrojë nga ndërlikimet e rënda të COVID-19. Arsyeja përse ne ia ofrojmë vaksinën popullatës është që të mbrojmë njerëzit dhe të reduktojmë sëmundjen dhe vdekjet e shkaktuara nga ky virus.

Unë e kam kaluar COVID-19, a më duhet ta bëj vaksinën?

Po. Edhe nëse e keni kaluar COVID-19, mund ta bëni sërish atë.

Vaksina do të reduktojë rrezikun tuaj që të infektoheni me COVID-19 sërish. Edhe nëse infektoheni me COVID-19 sërish, vakcina mund të reduktojë rëndesën e simptomave tuaja.

Unë kam COVID-19 tani, a duhet ta bëj vaksinën?

Jo. Ju duhet ta shtyni bërjen e vaksinës derisa të shëroheni nga COVID-19. Bëni këtë më për:

- të paktën katër javë pas simptomave tuaja të para ose
- katër javë që kur testi i COVID-19 ju ka dalë pozitiv

Bërja e vaksinës

Kush është vaksinuesi im?

Vaksinuesi është personi i cili ju bën vaksinën. Ata janë trajnuar nga HSE-ja që të bëjnë vaksinat ndaj COVID-19.

A mund t'ju japë vakcina e COVID-19 infeksionin e COVID-19?

Jo. Vakcina e COVID-19 nuk mund t'ju japë infeksionin e COVID-19. Mundet që të jeni infektuar me COVID-19 përpara se ta bëni vaksinën dhe të mos e keni kuptuar që keni simptoma deri pas bërjes së vaksinës.

Nëse keni simptomat e zakonshme të COVID-19, është e rëndësishme të vetë-izoloheni (qëndroni në dhomën tuaj) dhe organizoni një test falas për të mësuar nëse keni COVID-19.

Nëse keni temperaturë që fillon më shumë se dy ditë pasi të keni bërë vaksinën ose zgjat më gjatë se dy ditë, duhet të vetë-izoloheni dhe të bëni një test COVID-19.

Nëse keni simptoma pas dozës së parë, sërish duhet të merrni dozën e dytë. Ndërkohë që mund të merrni një lloj mbrojtjeje nga doza e parë, marrja e dozës së dytë do t'ju japë juve mbrojtjen më të mirë ndaj virusit.

A duhet ta bëj vaksinën e COVID-19 nëse kam temperaturë të lartë?

Jo. Ju duhet ta shtyni bërjen e vaksinës nëse keni temperaturë (temperaturë prej 38 gradë celsius ose më të lartë), derisa ju të ndiheni më mirë.

A është e sigurt ta bëj vaksinën nëse jam shtatzënë ose po ushqej me gji?

Nuk ka dëshmi që vaksina COVID-19 të jetë e pasigurt nëse jeni shtatzënë.

Vaksinat ndaj COVID-19 nuk janë testuar te gratë shtatzëna gjatë provave klinike. Megjithatë, mbi 100.000 gra shtatzëna në SHBA e kanë bërë vaksinën ndaj COVID-19. Nuk janë identifikuar shqetësime për to ose foshnjat e tyre.

Rekomandohet që ta bëni vaksinën e COVID-19 kur t'ju ofrohet. Duke u vaksinuar do të reduktoni shanset që të sëmurëni.

Nëse jeni shtatzënë, duhet të flisni me obstetrin ose mjekun tuaj të përgjithshëm rreth bërjes së vaksinës ndaj COVID-19. Ju mund ta bëni vaksinën ndaj COVID-19 nëse po ushqeni me gji.

Çfarë vaksine po më ofrohet?

Vaksina që po ju ofrojmë quhet Comirnaty, e prodhuar nga Pfizer/BioNTech.

Kjo vaksinë mRNA i mëson trupit tuaj të krijojë një proteinë që do të nxisë një reagim imunitar, pa përdorur virusin e gjallë që shkakton COVID-19.

Më pas trupi juaj do të krijojë antitrupa që ndihmojnë në luftën kundër infeksionit nëse virusi i vërtetë hyn në trupin tuaj në të ardhmen.

A është e sigurt vaksina?

HSE-ja i përdor vaksinat vetëm kur ato plotësojnë standardet e kërkuara të sigurisë dhe efektshmërisë.

Ndërkohë që puna për të zhvilluar vaksinat COVID-19 ka ecur përpara shumë më shpejt sesa zakonisht, vaksina që po ju ofrojmë ka kaluar të gjitha hapat e nevojshme për të zhvilluar dhe miratuar një vaksinë të sigurt dhe të efektshme.

Për t'u miratuar për përdorim, vaksina COVID-19 ka kaluar të gjitha provat klinike dhe kontrollet e sigurisë që kalojnë të gjitha barnat e licencuara, sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë.

Vaksina që po ju ofrojmë quhet Comirnaty, e prodhuar nga Pfizer/BioNTech. Ajo:

- ✓ është testuar te mijëra njerëz si pjesë e provave klinike
- ✓ ka plotësuar standardet e sigurisë, cilësisë dhe efektshmërisë dhe është miratuar e licencuar nga rregullatorët. Për Irlandën, rregullatori është Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) - vizitoni www.ema.europa.eu për më shumë informacion

Si jepet vaksina e COVID-19?

Vaksina e COVID-19 jepet si një injeksion në pjesën e sipërme të krahut tuaj. Kjo gjë zgjat vetëm pak minuta.

Sa doza të vaksinës COVID-19 do të më duhen?

Ju duhet të bëni dy doza të vaksinës COVID-19 për të marrë mbrojtjen më të mirë. Ju duhet ta bëni dozën e dytë 21 - 28 ditë pas dozës së parë. Ju duhet të merrni një dozë të dytë 28 ditë (katër javë të plota) pas dozës së parë.

Cilat janë efektet anësore të vaksinës?

Sikurse të gjitha barnat, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica prej tyre janë të lehta deri mesatare, afatshkurtër dhe jo të gjithë i kalojnë ato.

Më shumë se një në 10 persona mund:

- të ndihen të lodhur
- të jenë pak të ndjeshëm ose të kenë ënjtje në krahun ku është bërë injeksioni i vaksinës
- të kenë dhimbje koke
- të kenë dhimbje muskujsh
- të kenë dhimbje kyçesh
- të kenë diarre
- të kenë temperaturë (temperaturë prej 38 gradë celsius ose më të lartë)

Më shumë se 1 në 100 persona mund të zhvillojnë të përziera, të vjella ose skuqje në vendon ku ju është bërë vakcina.

Më shumë se 1 në 1000 persona zhvillojnë të kruajtura në vendin ku është bërë vakcina, kruarje të përgjithshme, rash, ënjtje të gjendrave limfatike ose pagjumësi. Paraliza e Bellit sëhtë një efekt anësor i rrallë i parë në më shumë se 1 në 10 000 persona.

Rrallë, personat që kanë asur mbushës facialë mund të zhvillojnë enjtje të fytyrës. Kjo shihet në më shumë se 1 në 10 000 persona.

Vaksina e COVID-19 ka kaluar nëpër të njëjtat prova klinike dhe kontrole të sigurisë sikurse dhe të gjitha vaksinat e tjera të licencuara, megjithatë vakcina është e re ndaj informacioni mbi efektet anësore afatgjata është i kufizuar.

Shumë rrallë, njerëzit mund të zhvillojnë miokardit ose perikardit pas marrjes së vaksinës Pfizer/BioNTech. Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje inflamatorë të zemrës. Rreziku për këto gjendje shumë të rralla është më i lartë te djemtë e rinj.

Miokarditi u raportua në rreth 1 në 1,000,000 doza të vaksinës. Megjithatë, të dhëna nga Shtetet e Bashkuara vlerësojnë se pas dozës së dytë të vaksinës, rreziku për miokardit është më i lartë për djemtë e rinj.

Rreziku i vlerësuar është:

- 1 në 16,000 në djemtë e rinj midis moshës 12–17 vjeç
- 1 në 20,000 në djemtë e rinj midis moshës 18–24 vjeç
- 1 në 100,000 vajza të reja midis moshës 12–17 vjeç

Perikarditi u raportua në rreth 1 në 1,000,000 doza të vaksinës. Këto kushte kanë më shumë gjasa të shfaqen pas dozës së dytë të vaksinës dhe ndodhin më shumë brenda 14 ditëve pas marrjes së vaksinës.

Ndërkohë që shumë njerëz në Irlandë dhe nëpër botë e bëjnë këtë vaksinë, mund të ketë në dispozicion më shumë informacion rreth efekteve anësore. HSE-ja do ta përditësojë këtë informacion rregullisht në faqen tonë të internetit dhe nëse është e nevojshme, do të përditësojë fletëpalosjet e informacionit që iu jepen njerëzve në dozën e tyre të parë ose të dytë të vaksinimit.

Temperatura pas vaksinimit

Është shumë e zakonshme të keni temperaturë pas një vaksinimi. Kjo zakonisht ndodh brenda dy ditësh (48 orësh) pasi e keni bërë vaksinën dhe largohet brenda dy ditësh.

Ka më shumë të ngjarë të keni temperaturë pas dozës tuaj të dytë të vaksinës. Nëse nuk ndiheni rehat, merrni paracetamol ose ibuprofen siç udhëzoheni në kuti ose fletëpalosje.

Nëse jeni i shqetësuar, ju lutemi kërkoni këshilla mjekësore.

Simptomat e miokarditit dhe perikarditit

Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje që shkaktojnë inflamacion të zemrës. Edhe pse rreziku për të shfaqur këto gjendje është shumë i ulët, ju duhet të dini shenjat që duhet të keni parasysh: Kërkoni ndihmë mjekësore nëse shfaqni ndonjë prej këtyre simptomave pas vaksinës së Pfizer/BioNTech:

- pamundësi për të marrë frymë
- palpitacione (rrahje të forta zemre që mund të jenë të çrregullta)
- dhimbje kraharori

A ka njerëz të cilët nuk duhet ta marrin vaksinën COVID-19?

Po. Ju nuk duhet ta merrni vaksinën COVID-19 Pfizer/BioNTech nëse:

- ✗ keni një reaksion të rëndë alergjik ndaj çdo përbërësi në vaksinë (përfshi glikol polietilenit ose PEG). Lexoni Fletëpalosjen me Informacion për Pacientin për të parë listën e përbërësve.
- ✗ keni pasur një reaksion alergjik të rëndë ndaj një doze të mëparshme të vaksinës ose vaksina e COVID-19 Moderna (Spikevax).
- ✗ ju ka thënë doktori se nuk duhet të bëni vaksinën e COVID-19 Moderna (Spikevax) ose vaksinën e COVID-19 Pfizer/BioNTech.
- ✗ ju shfaqët miokardit pas një doze të mëparshme të kësaj vaksine ose të vaksinës së COVID-19 të Moderna (SpikeVax).

Bisedoni me mjekun tuaj përpara se të bëni vaksinën e COVID-19 nëse:

- keni pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të shkuarën ndaj ndonjë vaksine ose mjekimi tjetër.
- shfaqët perikardit pas një doze të mëparshme të kësaj vaksine ose të vaksinës së COVID-19 të Moderna (SpikeVax)

Bisedoni me mjekun tuaj përpara se të bëni vaksinën e COVID-19 nëse keni pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj ndonjë vaksine ose mjekimi tjetër.

Nëse keni pasur një reaksion alergjik ndaj çdo vaksine tjetër ose terapie të injektuar, duhet të flisni me mjekun tuaj rreth marrjes së vaksinës COVID-19.

Në pjesën e pasme të kësaj fletëpalosjeje, do të gjeni këshilla rreth kujdesit pas vaksinës.

Ata do t'ju japin edhe një fletëpalosje me këshilla për kujdesin e mëtejshëm dhe një kartë ku të jetë shënuar emri dhe numri i grupit të vaksinës që ju është dhënë.

Sa kohë duhet që vaksina të funksionojë?

Pas marrjes së të dyja dozave të vaksinës së COVID-19, shumica e njerëzve kanë imunitet. Kjo do të thotë se ata do të jenë të mbrojtur ndaj COVID-19.

Duhet 7 ditë pasi të bëhet doza e parë e vaksinës që ajo të funksionojë.

Ka një mundësi që sërish të infektoheni me COVID-19 edhe nëse e keni bërë vaksinën.

A funksionon vaksina tek të gjithë?

Në mbarë botën, vaksinat shpëtojnë të paktën 2 deri në 3 milionë jetë çdo vit dhe mbrojnë shumë të tjerë nga sëmundjet afatgjata. Miliona vetë i kanë bërë tani vaksinat e COVID-19 në mbarë botën.

Ka prova të forta dhe të besueshme se vaksinat e COVID-19 reduktojnë shumë rrezikun tuaj të infektimit me COVID-19.

Ato janë shumë efikase në parandalimin e vdekjeve dhe sëmurjes rëndë me COVID-19.

Nëse keni një sistem imunitar të dobësuar, nuk ka rrezik shtesë që ta bëni vaksinën por ajo mund të mos funksionojë po aq mirë për ju.

Kur ta bëj vaksinën, a do të thotë kjo që unë nuk do ta përhap COVID-19 tek të tjerët?

Ne nuk e dimë ende nëse bërja e vaksinës ju pengon që ta përhapni virusin COVID-19 tek të tjerët. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që ne të gjithë të vazhdojmë të ndjekim këshillat e shëndetit publik se si ta ndalojmë përhapjen e virusit.

Në veçanti, ju sërish duhet të:

- ndiqni udhëzimet e distancimit social (qëndroni dy metra larg nga të tjerët kur është e mundur)
- mbani një maskë
- lani duart rregullisht

Ju falënderojmë që po mbroni veten dhe të tjerët.

Sa kohë zgjat imuniteti nga vaksina?

Ne nuk e dimë ende se sa kohë do të vazhdojë imuniteti. Provat klinike po vazhdojnë për ta mësuar këtë gjë.

Informacion shtesë

Për më shumë informacion, lexoni Fletëpalosjen me Informacion për Pacientët Ajo do të printohet për ju ditën që vaksinoheni, ose Fletëpalosjen me Informacion për Pacientët mund ta gjeni në **www.hse.ie/covid19vaccinePIL**

Ju mund të flisni edhe me një profesionist të shëndetit, si për shembull me një mjek të përgjithshëm (doktor), farmacist ose ekip të kujdesit shëndetësor.

Mund të vizitoni edhe faqen e internetit të HSE-së në **www.hse.ie/covid19vaccine**, ose të telefononi HSElive në numrin **1800 700 700**.

Për më shumë informacion mbi vaksinën e COVID-19, përfshirë materiale në formate të tjera dhe mbështetje me përkthimin, vizitoni **www.hse.ie/covid19vaccinematerials**

Si t'i raportoj efektet anësore?

Sikurse me të gjitha vaksinat, ju mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara tek Autoriteti Rregullator i Produkteve (HPRA).

HPRA-ja është autoriteti rregullator në Republikën e Irlandës për barnat, pajisjet mjekësore dhe produktet e tjera të shëndetit. Si pjesë e rolit të tij në monitorimin e sigurisë së barnave, HPRA-ja operon një sistem nëpërmjet të cilit profesionistët e kujdesit shëndetësor ose anëtarët e publikut mund të raportojnë çdo reaksion të dyshuar negativ (efektet anësore) që kanë të bëjnë me barnat dhe vaksinat që kanë ndodhur në Irlandë.

HPRA-ja e nxit fuqishëm raportimin e reaksioneve negative të dyshuara (efekteve anësore) që kanë lidhje me vaksinën e COVID-19 për të mbështetur monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë së tyre dhe përdorimin e efektshëm. Për të raportuar një reaksion negativ të dyshuar ndaj vaksinës COVID-19, ju lutemi vizitoni **www.hpra.ie/report**

Ju mund t'i kërkonti edhe mjekut tuaj të familjes ose një anëtar të familjes që ta raportojë këtë për ju. Duhet dhënë sa më shumë informacion nga informacioni që dihet dhe kur është e mundur, numri i grupit të vaksinës duhet të përfshihet.

HPRA-ja nuk mund të japë këshilla klinike mbi raste individuale. Anëtarët e publikut duhet të kontaktojnë profesionistët e tyre të kujdesit shëndetësor (Mjekun ose Farmacistin e tyre) për çdo problem mjekësor që mund të kenë.

Informacioni juaj personal

Për ta administruar vaksinën në mënyrë të sigurt dhe për të regjistruar të gjitha informacionet e nevojshme për të monitoruar dhe menaxhuar vaksinën, HSE-ja do ta përpunojë informacionin tuaj personal. I gjithë informacioni i përpunuar nga HSE-ja do të jetë në pajtim me ligjet e përgjithshme dhe në veçanti me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrotjtjen e të Dhënave (GDPR) që ka hyrë në fuqi në vitin 2018.

Përpunimi i të dhënave tuaja do të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Ato do të përpunohen vetëm për qëllime specifike për të menaxhuar vaksinimet. Është zbatuar parimi i Minimizimit të të Dhënave. Kjo do të thotë se vetëm të dhënat që janë të nevojshme për t'ju identifikuar, për

të rezervuar takimin tuaj, për të regjistruar vaksinën dhe për të monitoruar efektet e saj po regjistrohen.

Ju keni të drejtat e mëposhtme si një subjekt i të dhënave sipas GDPR në lidhje me të dhënat tuaja personale që janë përpunuar.

- Të kërkonti informacion dhe qasje në të dhënat tuaja personale (që zakonisht njihet si një “kërkesë për qasje në të dhënat e subjektit”). Kjo ju mundëson të merrni një kopje të të dhënave personale që ne mbajmë për ju dhe të kontrolloni se ne po i përpunojmë ato në mënyrë të ligjshme.
- Të kërkonti ndreqjen e të dhënave personale që ne mbajmë për ju. Kjo ju mundëson të korrigjohet çdo informacion i paplotë ose i pasaktë që ne mbajmë mbi ju.
- Të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja personale. Kjo ju mundëson juve të na kërkonti të fshijmë ose heqim të dhënat personale kur nuk ka një arsye të fortë që ne të vazhdojmë t’i përpunojmë. Ju keni të drejtën të na kërkonti të fshijmë ose heqim informacionin tuaj personal kur keni ushtruar të drejtën tuaj ta kundërshtoni përpunimin.
- Të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale.

Më shumë informacion gjendet në **www.hse.ie/eng/gdpr**

Pas vaksinës tuaj Comirnaty (Pfizer/BioNTech) COVID-19

Ju faleminderit që po e mbroni veten dhe të tjerët duke bërë vaksinën. Tani që e keni bërë vaksinën tuaj, ne ju kërkojmë që ta lexoni këtë dokument me kujdes, në mënyrë që të dini se çfarë duhet të prisni që të ndieni në ditët e ardhshme dhe ku të merrni më shumë informacion.

Lexojeni të gjithë informacionin që ju është dhënë sot.

Ne po ju japim edhe një fletë në të cilën thuhet se e keni bërë vaksinën sot. Ju lutemi mbajeni kartën e bërjes së vaksinës të sigurt.

Çfarë mund të ndodhë në ditët e ardhme?

Disa njerëz që e kanë bërë vaksinën që bëtë ju sot do të:

- jenë pak të ndjeshëm, do të kenë ënjtje ose skuqje në krahun ku kanë bërë injeksionin e vaksinës
- ndihen të lodhur
- kenë dhimbje koke
- kenë dhimbje muskujsh
- kenë dhimbje kyçesh
- kenë të diarre
- kenë temperaturë (temperaturë prej 38 gradë celsius ose më e lartë).

Një numër shumë i vogël njerëzish që kanë marrë vaksinën, zhvilluan miokardit (inflamacion i muskulit të zemrës) dhe perikardit (inflamacion i shtresave që veshin zemrën).

Rreziku i këtyre gjendjeve shumë të rralla është më i lartë te djemtë e rinj. Ka më shumë të ngjarë të shfaqet pas dozës së dytë dhe zakonisht ndodh brenda 14 ditëve pas marrjes së vaksinës.

Duhet të kërkonin ndihmën e duhur mjekësore dhe të përmendni vaksinimin tuaj të fundit nëse:

- nuk merrni dot frymë
- keni palpitacione (rrahje të forta zemre që mund të jenë të çrregullta)
- keni dhimbje krahbarori

Sikurse me të gjitha vaksinat, ju mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara te Autoriteti Rregullator i Produkteve (HPRA). Për të raportuar efektet anësore të vaksinës së COVID-19, ju lutemi vizitoni **www.hpra.ie/report**

Çfarë ndodh nëse unë kam temperaturë ose dhimbje?

Nëse keni temperaturë apo dhimbje, mund të merrni paracetamol ose ibuprofen për t'ju ndihmuar. Megjithatë, nëse temperatura juaj zgjat më shumë se 48 orë ose nëse jeni ende i shqetësuar, ju lutemi kërkonin këshilla mjekësore. Mos merrni ibuprofen nëse jeni shtatzënë.

A më duhet të bëj ndonjë gjë përpara se të marr dozën e dytë të vaksinës?

Kur të merrni dozën tjetër dhe përfundimtare të vaksinës, ju lutemi thuajini ekipit të vaksinave nëse ka pasur ndonjë ndryshim në historikun tuaj mjekësor.

Silleni kartën tuaj të regjistrimit të vaksinave me vete kur shkoni për të bërë dozën e dytë. Kjo gjë do të bëhet pas 21 - 28 ditësh.

Silleni kartën tuaj të regjistrimit të vaksinave me vete kur shkoni për të bërë dozën e dytë. Kjo gjë do të bëhet pas 21 ditësh (tre javë).

Lajmi i mirë

Bërja e vaksinës COVID-19 duhet t'ju mbrojë nga ndërlikimet e rënda të COVID-19.

Vaksinat mësojnë sistemit tonë imunitar t'ju mbrojnë nga sëmundjet. Është shumë më e sigurt për sistemin tonë imunitar që ta mësojë këtë nëpërmjet vaksinimit sesa të infektohet me COVID-19.

Ne ende po mësojmë

Duhen 7 ditë pasi të bëhet doza e parë e vaksinës që ajo të funksionojë.

Ka një mundësi të vogël që sërisht të infektoheni me COVID-19 edhe nëse e keni bërë vaksinën.

Ne nuk e dimë ende nëse bërja e vaksinës ju pengon që ta përhapni virusin tek të tjerët, ndaj duhet të vazhdoni të ndiqni këshillat e shëndetit të publik:

- Ndiqni udhëzimet e distancimit social
(qëndroni dy metra larg nga të tjerët kur është e mundur)
- mbani një maskë
- lani duart rregullisht

Keni ndonjë pyetje?

Nëse nuk jeni i sigurt rreth diçkaje ose keni ndonjë pyetje rreth vaksinës COVID-19, ju lutemi na pyesni tani ose vizitoni **www.hse.ie/covid19vaccine** ose telefononi HSELive në numrin **1800 700 700**.

Efektet anësore

Raportoni çdo efekt anësor te HPRA në **www.hpra.ie/report**



**COVID-19
VACCINE**
Public Health
Advice

Botuar nga HSE më
9 gusht 2021

Për informacionin më të përditësuar vizitoni
www.hse.ie



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland